RELACION
SHPJEGUES PËR PROJEKTVENDIMIN
"PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E PROFILIT TË RREZIKUT NË NIVEL KOMBËTAR TË FURNITORËVE DHE OFRUESVE TË PAJISJEVE TË RRJETIT 5G"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e profilit të rrezikut në nivel kombëtar të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit 5G", vjen si propozim i Ministrit për Infrastruturën dhe Energjinë, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 55, të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Ky projektakt ka për qëllim të miratojë metodologjinë për vlerësimin e profilit të rrezikut të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit 5G, duke pasur parasysh rëndësinë e identifikimit dhe menaxhimit të burimeve të mundshme të rrezikut në sigurinë e këtyre rrjeteve. Projektakti synon të plotësojë kuadrin nënligjor të nevojshëm për zbatimin e Ligjit Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", në harmoni me Rekomandimin e Komisionit Evropian (BE) 2019/534 të datës 26 mars 2019 "Siguria kibernetike e rrjeteve 5G", në kuadër të zbatimit të 5G Toolbox.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi lidhet me zbatimin e ligjit Nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Projektvendimi është parashikuar në Planin Analitik të akteve për vitin 2025, dhe lidhet me përmbushjen e piketave përmbyllëse për integrimin në BE të Kapitullit 10 "Transformimi Digjital dhe Media".

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i cili ka transpozuar Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike", në pikën 7 të nenit 55, ka parashikuar miratimin e metodologjisë për vlerërësimin e profilit të rrezikut në nivel kombëtar të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit 5G.

Ligji nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ne kreun VII, percakton kerkesat për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve, si dhe ka përcaktime për garancitë dhe sigurinë e furnizuesve dhe ofruesve të rrjetit. Ne lidhje me masat e sigurise se rrjeteve, janë përafruar në mënyrë të plotë nenet 40 dhe 41 te Direktivës së BE per Komunikimet Eletronike. Gjithashtu me nenin 55, “*Garancitë dhe siguria e furnizuesve dhe ofruesve të rrjetit*” parashikohen disa masa për garantimin e sigurisë të ofruesve, furnizuesve të pajisjeve të rrjeteve 5G dhe rrjeteve të gjeneratës së ardhme ne perputhje me Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 mars 2019 “Cyber-security e rrjeteve 5G”.

Me anë të projektvendimit “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e profilit të rrezikut të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit, komponentëve kritikë dhe pjesëve të ndjeshme të 5G”, synohet të plotësohen paketa për vlerësimin e rrezikut të profilit të furnitoreve të rrjeteve 5G, në harmoni me Rekomandimin e Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 Mars 2019 “Cyber-security e rrjeteve 5G”, 5G Toolbox. Projektakti per “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e profilit të rrezikut të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit, komponentëve kritikë dhe pjesëve të ndjeshme të 5G” vjen si propozim pas miratimit të VKM nr. 570 datë 8.10.2025, “Miratimin e listës me përbërësit kritike dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G”.

Projektakti për miratimin e kësaj metodologjie është në përputhje me parashikimin e pikës 7, të nenit 55 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Miratimi i saj është i rëndësishëm sepse përcakton kriteret e standartizuara për të vlerësuar rrezikun që paraqesin furnizuesit dhe pajisjet e rrjetit, duke ndihmuar autoritetet përgjegjëse të mbrojnë sigurinë e rrjeteve 5G. Në kushtet kur sulmet kibernetike janë gjithnjë në rritje një metodologji e miratuar zyrtarisht siguron bazë ligjore për përjashtimin e furnizuesve me rrezik të lartë, duke ruajtur në të njëjtën kohë besueshmërinë e rrjetit dhe interesin publik.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 dhe 9 të nenit 55 të ligjit Nr.54/2024, datë 30.5.2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky vendim nuk bën përafrim të ndonjë acquis specifike por është në harmoni dhe në zbatim të Rekomandimit të Komisionit Evropian (BE) 2019/534 të datës 26 Mars 2019 "Siguria kibernetike e rrjeteve 5G", 5G Toolbox.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti propozon miratimin e një metodologjie të detajuar për vlerësimin e profilit të rrezikut të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjeteve 5G, si dhe të komponentëve kritikë dhe pjesëve të ndjeshme të këtyre rrjeteve. Projektakti bazohet në nevojën për të garantuar sigurinë kibernetike të infrastrukturave strategjike kombëtare në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për sigurinë e rrjeteve 5G.

Projektakti përmban dy nene, ku Neni 1, parashikon miratimin e metodologjisë së vlerësimit të profilit të rrezikut, siç është përcaktuar në aneksin bashkëngjitur projektvendimit. Neni 2, ngarkon Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Metodologjia e përshkruar në dokumentin bashkëlidhur, përbëhet nga pesë nene dhe tri shtojca si më poshtë:
Në nenin 1, jepet qëllimi për përcaktimin e metodologjisë për vlerësimin e profilit të rrezikut të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit, komponentëve kritike dhe pjesëve të ndjeshme të 5G, sipas parashikimeve të nenit 55, ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".
Neni 2, përcakton fushën e zbatimit duke qartësuar se metodologjia zbatohet për rrjetet 5G, që qëndrojnë me vehte (*Stand Alone*) dhe për rrjetet që nuk qëndrojnë apo zhvillohen më vehte (*Non Stand Alone*) dhe për aq sa është e aplikueshme për operatorët e rrjetit virtual MVNO.
Në nenin 3, jepen "Parimet e përgjithshme" mbi të cilat bazohet metodologjia për vlerësimin objektiv, transparent dhe proporcional sipas nivelit të rrezikut si dhe në parimin e neutralitetit teknologjik. Metodologjia do bazohet në qasjen e vlerësimit të rrezikut ("Risk Based Approach") sipas praktikës së BE-së në zbatim të 5G toolbox të BE-së dhe i shërben zbatimit të masave të sigurisë të përcaktuara në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Kjo metodologji synon gjithashtu përforcimin e sigurisë në projektimin, vendosjen dhe funksionimin e rrjeteve 5G, ngritjen e standardeve bazë të sigurisë për pajisjet, rrjetet dhe shërbimet, zbutjen e rreziqeve të sigurisë së rrjetit nga furnitorët dhe ofruesit e rrjetit, shmangien ose kufizimin e varësive të mëdha nga çdo furnizues i vetëm në rrjetet 5G si dhe promovimin e një tregu të larmishëm, konkurrues dhe të qëndrueshëm për pajisjet e rrjetit 5G, duke përfshirë edhe ruajtjen e kapaciteteve në zinxhirin e vlerës 5G sipas praktikave të mira.

Në nenin 4, "Perkufizimet", në tërësi termat e përdorur në projekt akt janë ato të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", por është parë e nevojshme dhënia në veçanti përkufizimi për rrjetet 5G, duke qartësuar se me "*Rrjet 5G" nënkuptohet tërësia e elementëve përkatës të infrastrukturës së rrjetit dhe teknologjinë e komunikimeve pa tel që përdoret për lidhjen dhe ofrmin e shërbimeve me vlerë të shtuar dhe me karakteristika të avancuara të performancës si me shpejtësi dhe kapacitet shumë të lartë të të dhënave, vonesë e ulët ne komunikim, besueshmëri mjaft të lartë, ose që mbështet një numër të madh pajisjesh të lidhura, ku mund të përfshihen elementët e trashëguar të rrjetit bazuar në gjeneratat e mëparshme të teknologjisë së rrjeteve te levizshme pa tel, të tilla si 4G ose 3G. Rrjetet 5G do te kuptohen që përfshijnë të gjitha pjesët përkatëse të rrjetit të lëvizshëm".* Ky përkufizim është në përputhje dhe me përcaktimet në 5G toolbox.

Në nenin 5, jepet "Procedura e vlerësimit". Në këtë nen jepet procedura e detajuar që do ndiqet ne procesin e vleresimit te profilit te rrezikut te furnitoreve per pajisjet e rrjetit 5G nga AKEP. Procesi parashikon që AKEP u kërkon operatorëve informacion për pajisjet sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës me përbërësit kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G", e miratuar me VKM nr. 570 datë 8.10.2025. Më pas operatorët e rrjeteve 5G, paraqesin pranë AKEP informacionin e kërkuar jo më vonë se 30 ditë nga kërkesa e AKEP. Për vlerësimin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, afati për paraqitjen e informacionit është jo më shumë se 60 ditë nga marrja e kërkesës. AKEP, nga momenti i marrjes së informacionit të paraqitur nga operatorët, bën vlerësimin e detajuar të informacionit brenda 90 ditëve kalendarike. Në procesin e vlerësimit AKEP, merr në konsideratë edhe informacionet e raportimeve periodike nga sipërmarrësit ose autoriteti përgjegjës, mbi incidentet kibernetike të ndodhura gjatë vitit të fundit, si dhe raportime që mund të jenë bërë nga sipërmarrësit bazuar e parashikimet e nenit 157, të ligjit 54/2024. Vlerësimi i riskut nga AKEP mban parasysh kategorizimin e rreziqeve sipas tabelës që jepet ne shtojcen 1. Tabela që është bazuar në praktikën e zhvilluar nga BE mbi bazën e 5G Toolbox, e cila orienton mbi skenarët dhe burimet e mundshme të rrezikut 5G, për të dalluar dhe përjashtuar ato rreziqe që nuk lidhen me furnitorët dhe që janë objekt i kësaj metodologjie, ndërkohë që vlerësimi i plotë i nivelit të rreziqeve, me probabilitet dhe ndikim realizohet në dokumentet zbatuese sipas kësaj metodologjie. AKEP, do mbajë gjithashtu parasysh nëse nga operatori janë marrë masat teknike dhe veprimet mbështetëse për sigurinë e rrjeteve 5G, sipas përcaktimit në 5G Toolbox të listuara në Shtojcën 2, të kësaj metodologjie.

Gjithashtu bëhet edhe vlerësimi i rreziqeve nga dobësitë jo-teknike që lidhen me rrjetet 5G, të cilat përfshijnë mundësinë që furnizuesi të jetë subjekt i ndërhyrjeve nga një vend/qeveri e huaj dhe në pikën 11, të këtij neni, bazuar në praktikën e BE-së, në veçanti paragrafit 2.37, të dokumentit të BE toolbox për masat e eliminimit të rrezikut të rrjeteve 5G, që mban parasysh interesat e pronësisë, lidhjet e tjera me qeverinë ose autoritetet në vendet e treta, legjislacionin e vendeve të treta, veçanërisht në rastet kur mungojnë parimet ligjore ose demokratike ose kur nuk mund të zbatohen marrëveshje për sigurinë ose

mbrojtjen e të dhënave midis BE-së dhe vendit të tretë të caktuar si dhe lidhje me vende ose organizata të përfshira në operacione kibernetike ose aktivitete të tjera kundër Shqipërisë.
Nëse gjatë vlerësimit identifikohen furnitorë me rrezik të lartë, AKEP, pas konsultimit me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), analizon masat e marra nga operatorët dhe u kërkon atyre paraqitjen e një plani veprimi brenda 30 ditësh. Në rast se plani ose masat e propozuara nga operatorët rezultojnë të pamjaftueshme, AKEP, në bashkëpunim me AKSK, i paraqet ministrit kompetent një propozim për vendosjen e masave kufizuese, kohën e zbatimit të tyre si dhe propozimin për skemën e kompensimit nëse do jetë e nevojshme. Këto masa mund të përfshijnë heqjen ose zëvendësimin e pajisjeve të rrezikshme brenda afateve të përcaktuara, si dhe, sipas rastit, aplikimin e një skeme kompensimi që është e parashikuar në ligj.
Në projektakt parashikohet që Ministri jep mendimin mbi propozimin brenda 30 ditësh, ndërsa AKEP merr vendimin përfundimtar mbi masat kufizuese dhe mënyrën e zbatimit të tyre dhe gjithashtu është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masave të miratuara dhe raporton periodikisht tek ministri përgjegjës dhe AKSK. Në masat përfshihet heqja dhe/ose zëvendësimin i pajisjeve me rrezik të lartë brenda një afati të specifikuar;
Gjithashtu operatorët e rrjetit, përpara se të kryejnë investime të reja, që lidhen me pajisje sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës me përbërësit kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G", njoftojnë paraprakisht në AKEP.

Metodologjia përfshin tri shtojca në Shtojcën 1, jepet tabela me skenarët dhe burimet e mundshme të rrezikut 5G. Këto përcaktime janë sipas praktikës së BE. Shtojca 2, përmban masat teknike dhe specifike të sigurisë së rrjeteve 5G, e cila bazohet në praktikën e Bashkimit Evropian e zhvilluar në zbatim të Rekomandimit te Komisionit Evropian (EU) 2019/534. Përfshirja e listës së plotë të masave teknike dhe specifike që lidhen me sigurinë 5G shërben për qartësim të masave të lidhura ose jo me furnitorët e rrezikut të lartë që janë në vecanti në vëmendje të procesit që do kryhet sipas kësaj metodologjie, por pa lënë jashtë vëmendjes faktorët që mund të çojnë në rreziqe që mund të mos jenë të lidhur me furnitorët po me masa të tjera teknike apo specifike të sigurisë që janë parashikuar për t'u përmbushur nga operatorët në zbatim të nenit 54 dhe 157, të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Për të pasur një pasqyrë të plotë të referencave në tabelën e shtojcës 2, janë dhënë dhe shpjegimet për veprimet mbështetëse për garantimin e sigurisë së rrjeteve, ku paraqiten hapat që duhen ndjekur nga institucionet. Plotësimi i metodologjisë me këtë shtojcë siguron dhe harmonizimin me standardin e Bashkimit Evropian në lidhje me zbatimin e masave të "5G Toolbox" për eliminimin e rreziqeve në rrjetet 5G, duke shërbyer si një bazë e qartë dhe e detajuar për zbatim në praktikë. Shtojca e tretë përfshin lista e shkurtimeve teknike të përdorura në dokument.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë .

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKEP dhe AKSK, duke u bazuar në paktiken e zhvilluar ne Bashkimin Evropian ne zbatim te Rekomandimit te Komisionit Evropian (EU) 2019/534 të datës 26 mars 2019 "Siguria kibernetike e rrjeteve 5G" dhe në 5G Toolbox. Në kuadër të hartimit të këtij akti, janë zhvilluar konsultime me operatorët e rrjeteve celulare.

Projekt vendimi do të dërgohet për mendim përmes e-akteve tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociatori.

Projekt akti do të dërgohet për mendim me shkresë pranë AKEP dhe AKSK si dhe do të konsultohet përmes faqes së MIE me palët e interesuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.